## AKT THEMELIMI I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TE KUFIZUAR "LEKA"SHPK

Në Pogradec, sot më datën 27 prill 1994(nëntëdhjetë e katër), i nënë=
=shkruari Bajram Leka, i biri i Sebriut dhe i Tahires, i datëlindje 13 ma
1956,lindur në Proptisht dhe banues në Pogradec,lagjen nr. 3,palläti 133
me letër njoftimi personal AZ Nr. 122930, me cilësinë e ortakut të vetëm,
me vullnetin tim të lirë e të plotë,vendose të krijoj shoqërinë private
të ndër imit "LEKA"(SH.P.K.) Pogradec,ku do të jetë edhe selia e saj.

### SH Y R J E

Në kuptim të plotë të këtij akti themelues,ortaku i vetëm Bajram Leka,
është themelues i shoqërisë së ndërtimit "LEKA " Pogradec.

Qëllimi i këtij akti themelues është krijimi i shoqërisë private të
ndërtimit "LEKA",me seli në Pogradec dhe shtrirje në të gjithë teritorin
e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria "Leka" Pogradec ,regullon veprimtarinë e saj në përputhje me
aktin e themelimit,statutin e saj, me ligjin nr. 7512,dt. 10.8.1991 ,li=
gjin nr.7720,dt 14.6.1993"Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve'",
ligjin nr 7693 dt. 6.4.1993 " Për urbanistikën ,ligjin nr. 7638 dt. 19.3.
1992 dhe akte të tjera të legjislacionit shqiptar.

### O B J E K T I

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "LEKA " SH.P.K. do të jetë vep=
=rimtari ndërtimore":"Projektime e ndërtime objektesh banimi, shoqërore,
turistike,ujësjellësa,kanalizime,rrugë e tjera."

### AFATI I VEPRIMTARISË

Veprimtaria private e shoqërisë do të jetë efektive nga dita e regjis=
=trimit në Gjykatën e Tiranës si dhe pajisje me lejë për ushtrim profesi=
oni nga Dega e Tatimeve e Takseve Pogradec.Ajo do të ushtrojë veprimtarin
e saj nga viti 1994 deri në vitin 2014.

### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "LEKA ", përbëhet nga kontributi fille=
=star i ortakut të vetëm themelues ing Bajram Leka,i cili arin vlerën ---
100.000 lekë(njëqint mijë),tërësisht i shlyeshëm nga ana e tij,i nënësh=
=kruar dhe i depozituar në Bankën Tregtare Pogradec.

Ortaku i vetëm themelues ose persona të autorizuar prej tij ,kanë të
drejtë që me nxjerjen e bilanceve periodike ose vjetorë të përfitojnë për=
=qindjen e realizuar nga veprimtaria private.

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetrore ,siguri=
=met shoqërore e të tjera.

Për shkelje të ndryshme e të mundshme të parashikuara në statut,ortaku
themlues mund të marë masa ndëshkimore ndaj kujdo që dëmton pasurinë e
ndërmarjes.

./.

JURIDIKSIONI

Shoqëria "Leka " Pogradec e ka qëndrën në qytetin e Pogradecit.
Të gjitha mosmarëveshjet me personat juridikë, fizikë, vëndas apo të huaj,si dhe me organet shtetrore,zgjidhen me mirëkuptim në të kundërt zgjidhja e tyre mund të bëhet nga Gjykata e rrethit Pogradec.

THEMELUESI ORTAK I VETËM
BAJRAM LEKA

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA

Nr. 1122 Rep
Nr. ____ Kol.

VËRTETIM NËNËSHKRIMI

Sot më datën 6.5.1994(nënëtëdhejtë e katër),u paraqit persona.sh në Zyrën e Noterisë Pogradec,para meje noteres Anila Lefko Petrovski,Bajram Sabri Leka,me dt. lindje 1956,lindur në Proptisht dhe banues në Pogradec,madhor ,me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pa njohur prej mejë ,për identitetin e të cilit u sigurova nga letër njoftimi personal, i cili deklaroi se sa sipër është akti i themelimit të shoqërisë "LEKA"SH.P.K Pogradec,i redaktuar jashtë kësaj zyre ,me vullnetin e tij të lirë e të plotë e nënëshkroi atë regullisht dhe unë noterja e vërtetoj konform ligjës.-------

NOTERIA
ANILA LEFKO PERTOVSKI